



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1250/6 prot

Datë 20.05.2025

V E N D I M
Nr. 679/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.05.2025 me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-41483-03-18-2025, me objekt: “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2025 nga autoriteti kontrktor, Autoriteti Portual Durrës
- Ankimues:** “PC STORE” SHPK me Nipt. L01606034A dhe adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Portual Durrës
Lagja Nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi “PC STORE” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.03.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-41483-03-18-2025, me objekt: “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2025 nga autoriteti kontrktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 15.04.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “PC STORE” SHPK	5,109,5010	lekë skualifikuar
2. “Microtech Computer Systems” SHPK	6,493,580	lekë skualifikuar
3. “SINTEZA CO ” SHPK	0	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 05.05.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik "*Publikimi i Njoftimit të Anullimit*" për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentimin se "*në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme*".

II.5. Në datën 14.05.2025 operatori ekonomik "PC STORE" SHPK ka paraqitur ankesë në formë shkresore nëpërmjet postës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar", me Nr. REF-41483-03-18-2025, me objekt: "Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca", me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga ky operator ekonomik.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1250/1 prot., datë 14.05.2025, publikoi objektin e pretendimeve që operatori ekonomik ankimues "PC STORE" SHPK parashtron në ankesën me nr. 1250 prot., datë 14.05.2025.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1352/1 prot., datë 16.05.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1250/3 prot., datë 20.05.2025 me objekt "*Kthim-përgjigje*", është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, "PC STORE" SHPK ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mostrajtimin e ankesës së tij pasi nuk është respektuar afati ligjor për dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*"

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Përpara shqyrtimit në themel të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, Komisioni vlerëson të ndalet dhe të shqyrtojë respektimin e kushteve formale të ankesës nga operatori ekonomik ankimes, ku një prej të cilave është paraqitja e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike.

III.1.1. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”*

III.1.2. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

III.1.3. Në nenin 110, pikat 2 dhe 8, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar është parashikuar se: *2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave.*

III.1.4. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e*

procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit. 2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. “4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”

III.1.5. Në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar Sistemin e Ankesave Elektronike, duke mundur tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë, paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit/Entit Kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin e ankesave elektronike, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë Autoritetit/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Prej datës 20 mars 2024, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” paraqitja e ankesave dhe e argumenteve nga operatorët ekonomikë, bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike. Për procedurat e prokurimit të nisura përpara datës 20 Mars 2024, do të vijojnë të realizohen sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në momentin e fillimit/nisjes së tyre. Ndërsa, procedurat e prokurimit, që do të nisin (me nxjerrjen e urdhrit të prokurimit) në datë 20 mars e në vijim, do t’i nënshtrohen parashikimeve të reja ligjore. Komisioni thekson, se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, referuar nenit 111, ankesat dorëzohen vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se referuar pikës 42 të nenit 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, “Urdhri i prokurimit”, i cili është akti administrativ i nxjerrë nga autoriteti ose enti kontraktor pas fazës përgatitore të procesit për prokurimin e një objekti të caktuar, do të konsiderohet momenti i fillimit të procedurës konkrete të prokurimit për këtë objekt.”

Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor/entit kontraktor. Një ndër kushtet formale që duhet të respektohet, është edhe dorëzimi i ankesës dhe argumenteve pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit entit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. KPP konstaton, se operatori ekonomik, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 14.05.2025, ku kërkon kualifikimin e ofertës së tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ rezulton, se operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka dorëzuar ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën në formë shkresore të ardhur nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 14.05.2025, si dhe referuar shkresës me nr. 1352/13 prot., datë 16.05.2025, protokolluar me tonëm nr.1250/3, të dërguar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës, rezulton, se operatori ekonomik ka dorëzuar ankesë në datën 14.05.2025, pranë autoritetit kontraktor. KPP ju sjell në vëmendje, se më hyrjen në fuqi të ligjit “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të gjitha ankesat do të dorëzohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kjo përbën një element të domosdoshëm formal për paraqitjen e ankesës. Megjithëse operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor në rrugë shkresore, nuk ka respektuar kushtet formale të vendosura nga ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ligji përcakton, që ankesa të dorëzohet vetëm nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e ndodhur në fashikullin administrativ, konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar ankesën nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ashtu siç parashikohet nga ligji “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referuar arsyetimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka dorëzuar ankesën nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ankesa e

operatorit ekonomik “Pc STORE” SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a”, të pikës 2 të nenit 118, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit me “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-41483-03-18-2025, me objekt: “Blerje Kompjuterash, pajisje dhe licenca”, me fond limit 6.812.680 (Gjashtë milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2025 nga autoriteti kontrktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontrktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

